

FJALA E DEPUTETES ERMONELA FELAJ

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Të them të drejtën, më vjen mirë që ky sesion parlamentar po mbyllet me miratimin e një projektligji të tillë, si projektligji “Për regjistrin elektronik kombëtar të të dënuarve për krime seksuale”. E them këtë, sepse është një nga ato punët e pakta ndoshta, që nisen dhe përfundohen brenda dyerve të Kuvendit të Shqipërisë, por me një impakt shumë të gjerë për shoqërinë. Nga ana tjetër, nuk mund të rri pa e thënë konsideratën për disa kolegë që shprehën me tone të larta, me ironi, sarkazëm dhe cinizëm shqetësimin për pasionin e humbur të gjahtarëve, ndërkohë që, në fakt, gjahtarët e vërtetë janë ata që sot janë edhe mes nesh, që gjuajnë fëmijë, që gjuajnë gra, që gjuajnë vajza.

Për këta, në fakt, duhet të ngrihet zëri dhe për këta duhet të jetë merak. Më vjen mirë që kolegët ministra, të cilët, për shkak të miratimit të këtij projektligji, do të kenë disa detyrime, qëndruan deri në fund të kësaj seance. Është e rëndësishme që ata të parët të kuptojnë detyrimet që do të kenë për shkak të këtij projektligji, sepse jo në kohë të shkurtër, por në një kohë të arsyeshme do të thosha, do t’u takojë që të kujdesen për të vënë në punë një mekanizëm. Projektligji erdhi si rezultat i dy propozimeve, një propozimi të ardhur nga shoqëria civile, e para iniciativë qytetare e depozituar në Kuvendin e Shqipërisë, dhe një tjetër iniciativë e ardhur nga deputetja Xhixho, por, pavarësisht qëllimeve dhe dëshirave të mira, të dyja projektet kishin nevojë të sillleshin në trajtën e duhur ligjore dhe, çfarë është më e rëndësishmja, na duhej të bashkëpunonim në mënyrë të veçantë me AKSHI-n dhe me Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që të ndërtonim mekanizmin që e bën funksional të ashtuquajturin regjistër.

Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës nga 14 deri në 18 vjeç, marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura, marrëdhënie homoseksuale me dhunë me të rritur, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona pa zotësi për të vepruar, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim për përdorimin e armës, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke

shpërdoruar detyrën, marrëdhënie të tilla me persona në gjini ose kujdestari, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale në vende publike, dhuna seksuale, veprime të turpshme, ngacmime seksuale, janë krime seksuale, që në një hark kohor jo të vogël (unë jam munduar të kap të paktën 10 vjetët e fundit), kanë shënuar 1141 procedime penale në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe plot 471 persona të dënuar, për të cilët ka përfunduar procesi gjyqësor.

Nëse doni t'jua tregoj nëpërmjet një grafiku, që u mundova ta bëj gjatë ditës së sotme, do të shikoni qartësisht se trendi është në rritje, si për numrin e procedimeve të regjistruara, ashtu edhe për numrin e personave të dënuar. Një nga arsyet është fakti që në këto vite është punuar shumë me ndërgjegjësimin, sepse kallëzimi dhe hedhja dritë në këtë lloj territori është shumë e vështirë. Për këtë arsye, unë do ta çmoja fort faktin që sot kemi rritur numrin e psikologëve në shkolla, të cilin duhet ta shtojmë edhe më shumë, sepse është e rëndësishme që fëmijët, vajzat dhe djemtë, veçanërisht në zonat rurale, të kenë mundësi të flasin për atë që ndodh në jetët e tyre. Këtu u tha se është bërë pak për parandalimin. Për parandalimin e veçantë dhe atë të përgjithshëm ka vepruar ligji penal, sot dhe gjithë ditën. Për parandalime të tjera, sigurisht, ka qenë i rëndësishëm fakti që ne kemi vendosur psikologë në shkolla.

E treta, dua të sjell në vëmendje Konventën Europiane për Parandalimin e Dhunës dhe Ngacmimeve Seksuale në Vendin e Punës, që përsëri është një ndër ato veprime të mira që ka bërë Kuvendi i Shqipërisë. I citova këto krime, sepse shumë nga kolegët deputetë kanë pyetur gjatë këtyre ditëve cilat janë krimet seksuale. Këto janë krimet seksuale. E dini cilat janë më të përhapura? Vendin e parë e zë ngacmimi seksual. Të paktën në 4 apo 5 vjetët e fundit ngacmimi seksual ka pasur një rritje ekstreme, kjo edhe për faktin se ndodh online, ndodh në rrjete sociale. Veprimet e turpshme zënë vendin e dytë, marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura zënë vendin e tretë dhe aty-aty janë edhe marrëdhëniet seksuale me të mitur. Dua të tërheq vëmendjen se këtu bëhet fjalë për persona deri në 14 vjeç, një kategori që është totalisht e paaftë për t'u mbrojtur nga këta persona.

Krijimi i regjistrit do t'u japë mundësi të gjithë të interesuarve, jo thjesht organizatave që merren me mbrojtjen e fëmijëve, grave dhe vajzave, jo thjesht zyrave arsimore, jo thjesht Departamentit të Administratës Publike, jo thjesht çdo personi juridik, publik apo privat, që, për

aq sa është e nevojshme, të kuptojnë nëse një person, pavarësisht rehabilitimit, ka qenë ose jo i dënuar ndonjëherë në jetën e vet për njërin nga krimet seksuale. Kemi diskutuar shumë nëse ky model e ka apo jo fuqinë e duhur parandaluese dhe unë po ju them se e ka dhe nuk e ka vetëm ndaj personave të dënuar apo atyre që janë të rehabilituar dhe për shkak të ligjit konsiderohen të pa dënuar, por e ka edhe ndaj atyre që i kemi mes nesh. Jo më kot ka 30 vjet që konsiderohet fenomen shoqëror që zhvillohet kudo.

Në çdo cep ka një grabitqar, i gatshëm të sigurojë viktimën seksuale të radhës. Ky është një paralajmërim edhe për ata, sepse ai regjistër nuk do të përmbajë thjesht rekordet e dënimit, por do të pasurohet nëpërmjet të dhënave që përmbajnë baza të tjera shtetërore ku Policia e Shtetit ka akses, do t'i japë mundësinë policisë të lokalizojë vendndodhjen e personit, por njëkohësisht do të japë edhe detyrimin që të monitorojë veprimet e tij. Nga ana tjetër, edhe shoqëria, kushdo i interesuar për mbrojtjen e vetes, të fëmijëve, të grave, të vajzave, përfshirë këtu edhe viktimat e këtyre krimeve, do të kenë mundësi të informohet për atë që ka ndodhur më këta autorë. Pra, është një alarm edhe për ata që nuk e kanë kryer ende këtë krim, sepse duhet të kuptojnë se nëpërmjet këtij ligji do të marrin një vulë për gjithë jetën dhe nuk do të jetë e thjeshtë të realizosh atë që ne e kemi quajtur "riintegrim në shoqëri", sepse ky riintegrim do të ndërlihet edhe me një kujdes të veçantë për të mos ekspozuar asnjë kategori vulnerabël ndaj kontakteve, të cilat do të rrezikonin jetën dhe shëndetin e tyre.

Unë nuk kam dyshim se ky ligj do të votohet nga të gjithë kolegët dhe nuk besoj se ndonjë koleg ka pasur ndonjë qasje ekstreme. Gjej rastin të falënderoj veçanërisht kolegët e Komisionit të Ligjeve, të cilët kanë mbajtur qëndrime të ftohta, qëndrime prej profesionistësh, duke u dhënë fund emocioneve, sepse nuk është një nga ato histori ku debatohet me emocione, por për të cilën debatohet me logjikën e ligjit dhe ku sigurohet që ligji të bëhet i zbatueshëm dhe jo t'i krijojmë atij premisën që të mos kalojë barrierën kushtetuese! Shpresoj që në krye të 6 muajve, ashtu sikundër e kemi vendosur detyrimin për hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe njëkohësisht jemi kujdesur që ky gjashtëmuor të mos kalojë bosh, por Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme të marrin të gjitha masat përkatëse ligjore për ta bërë funksional regjistrin në kohën

e hyrjes në fuqi të ligjit, realisht ne ta kemi regjistrin funksional dhe për herë të parë të mbledhim në vendin tonë të dhëna lidhur me këta persona.

E dhëna që unë citova është marrë nga raportet e prokurorit të Përgjithshëm. Sigurisht që ka disa gjëra të rëndësishme, por ju e kuptoni edhe vetë që ky nuk është një studim i plotë dhe regjistri që jemi duke krijuar do të na japë mundësinë e pasjes së një panorame të plotë të të gjithë predatorëve seksualë: ku janë të vendosur sot, çfarë kategorie shoqërore përfaqësojnë, çfarë fashe moshore përfaqësojnë dhe ku janë të shpërndarë nëpër Shqipëri. Kjo vlen njësoj, pavarësisht nëse janë shtetas shqiptarë, janë shtetas të huaj që e kanë kryer këtë vepër në territorin e Shqipërisë apo persona pa shtetësi. Falënderoj për vëmendjen dhe respektin të gjithë kolegët që qëndruan në respekt të promovimit të përmbajtjes së këtij projektligji realisht shumë të rëndësishëm! Faleminderit!